

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-26-6338-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja dhe pershtatja e sistemit LIMS në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	PBC SH.P.K.
NUI	810845985
Adresa	Rruga Bekim Fehmiu, 91
Vendi	Prishtina
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044467467
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Bashkim Selmani
Adresa elektronike	bs@pbc.group
Data e parashtrimit të ankesës	26.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Mirëmbajtja dhe pershtatja e sistemit LIMS në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

Njoftimi për Kontratë: 31.07.2026;

Kërkesa për informacione shtesë: 13.08.2026;

Informacione/Sqarime shtesë të DT-së: 17.08.2026;

Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 18.08.2026;

Kërkesa për rishqyrtim: 18.08.2026;

Vendimi për kërkesën për rishqyrtim: 21.08.2026;

Afati për dorëzimin e ofertave: 28.08.2026.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Më datë 18.08.2026 është parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues (AK), në përputhje me nenin 108/A të LPP-së. Pas shqyrtimit të kërkesës, AK, më datë 21.08.2026, ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Në bashkëngjitje paraqitet kopja e vendimit të nxjerrë nga AK gjatë fazës paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 7 i LPP-së – trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi dhe konkurrenca efektive;
- Neni 9, paragrafi 1, pikat (i) dhe (iii) të LPP-së – përcaktimi i llojit dhe përmasave të sakta të nevojave dhe i specifikimeve funksionale të objektit të kontratës;
- Neni 27, paragrafi 1 i LPP-së – dosja duhet të përmbajë informatat relevante, të gjitha kushtet materiale dhe specifikimet teknike të zbatueshme;
- Neni 28, paragrafët 1 dhe 2 të LPP-së – specifikimet teknike dhe lidhja e tyre me qëllimin e prokurimit;
- Neni 28, paragrafi 8 i LPP-së – kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta, në mënyrë që tenderuesit të mund ta përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës;
- Neni 51, paragrafët 1 dhe 3 të LPP-së – kërkesat duhet të jenë të nevojshme, drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës;
- Nenet 4.1, 4.3, 17.12, 19.1, 19.3, 19.4 dhe 25.17 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në versionin e konsoliduar me Rregulloren Nr. 002/2024.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. Objekti dhe pranueshmëria e ankesës

PBC, në cilësinë e operatorit ekonomik me interes të drejtpërdrejtë për pjesëmarrje dhe kontraktim në aktivitetin e sipërshënuar, paraqet këtë ankesë kundër Vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 21.08.2026 dhe kundër kërkesave të Dosjes së Tenderit që vazhdojnë: (i) të kufizojnë konkurrencën pa një arsyetim objektiv dhe proporcional; (ii) të përjashtojnë ekspertë të kualifikuar përmes kërkesave formale të diplomës; dhe (iii) të lënë të papërcaktuar pjesë thelbësore të objektit, vëllimit, përgjegjësi dhe rrezikut kontraktual.

Parashtruesi i ka kundërshtuar me kohë këto çështje: më 13.08.2026 ka kërkuar informacione/sqarime, më 17.08.2026 AK-ja ka publikuar përgjigjet, ndërsa më 18.08.2026 PBC ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Me Vendimin e datës 21.08.2026, AK-ja e ka refuzuar kërkesën. Prandaj, ankesa ushtrohet pas shterimit të mjetit paraprak

pranë AK-së.

II. Dispozitat e shkelura

- Neni 7 i LPP-së – trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi dhe konkurrenca efektive;
- Neni 9, paragrafi 1, pikat (i) dhe (iii) të LPP-së – përcaktimi i llojit dhe përmasave të sakta të nevojave dhe i specifikimeve funksionale të objektit të kontratës;
- Neni 27, paragrafi 1 i LPP-së – dosja duhet të përmbajë informatat relevante, të gjitha kushtet materiale dhe specifikimet teknike të zbatueshme;
- Neni 28, paragrafët 1 dhe 2 të LPP-së – specifikimet teknike dhe lidhja e tyre me qëllimin e prokurimit;
- Neni 28, paragrafi 8 i LPP-së – kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta, në mënyrë që tenderuesit të mund ta përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës;
- Neni 51, paragrafët 1 dhe 3 të LPP-së – kërkesat duhet të jenë të nevojshme, drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës;
- Neni 108/A i LPP-së – shqyrtimi dhe zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve;
- Nenet 4.1, 4.3, 17.12, 19.1, 19.3, 19.4 dhe 25.17 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në versionin e konsoliduar me Rregulloren Nr. 002/2024.
- Këto dispozita duhet të lexohen së bashku: AK-ja fillimisht duhet ta përcaktojë saktë nevojën dhe objektin; pastaj t'i shndërrojë ato në specifikime dhe kushte materiale të qarta; ndërsa kriteret e kualifikimit duhet t'i kufizojë vetëm në atë që është e domosdoshme, relevante dhe proporcionale. Mangësia në cilëndo prej këtyre hallkave ndikon drejtpërdrejt në konkurrencë, në përgatitjen e ofertës dhe në krahasueshmërinë e çmimeve.

III. Pretendimet ankimore

Pretendimi 1 – Kriteret e diplomave janë të paarsyetuara, joproportionale dhe kufizuese

Kriteri aktual. Për Menaxherin e Projektit, Analistin e Sistemit dhe Arkitektin e Softuerit, DT 2026 pranon vetëm “Diplomë Universitare Inxhinier i Kompjuterikës me Telekomunikacion” ose Master të Shkencave Kompjuterike/Master të Inxhinierisë Kompjuterike. Ky formulim krijon një barrierë formale eliminimi dhe, në praktikë, përjashton diplomën relevante Bachelor sipas sistemit të Bolonjës, pavarësisht përvojës së dëshmuar, projekteve të ngjashme, rolit real dhe certifikimeve profesionale të kandidatit.

Përgjigjja e AK-së. Në sqarimet e datës 17.08.2026, AK-ja vetëm ka deklaruar se kërkesat mbesin të njëjta. Në vendimin e kontestuar, AK-ja përsërit në mënyrë të përgjithshme se sistemi është kompleks dhe se kriteret lidhen me objektin e kontratës, por nuk merr parasysh faktin se, në dy procedurat paraprake për mirëmbajtjen e të njëjtit sistem LIMS, me natyrë dhe kompleksitet materialisht të njëjtë, përkatësisht në vitet 2018 dhe 2022, këto kriteret nuk ishin kërkuar. Gjithashtu, AK-ja nuk identifikon asnjë ndryshim teknik ose funksional të sistemit që do ta arsyetonte vendosjen e tyre në vitin 2026, nuk përcakton asnjë detyrë konkrete që kërkon domosdoshmërisht nivelin Master dhe nuk shpjegon pse diploma relevante Bachelor, e kombinuar me përvojën dhe certifikimet e kërkuara, nuk do të ishte e mjaftueshme.

Barra e arsyetimit. Meqë kriteri i kontestuar kufizon konkurrencën, zvogëlon numrin e operatorëve ekonomikë që mund të marrin pjesë dhe krijon përparësi të pajustificuar për OE të caktuar që disponojnë paraprakisht profilet specifike akademike të kërkuara, nuk mjafton që AK-ja vetëm të deklarojë se e konsideron atë të përshtatshëm ose ta arsyetojë në mënyrë abstrakte me “kompleksitetin e sistemit”. AK-ja duhet të paraqesë një arsyetim teknik, konkret dhe të dokumentuar, të lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e secilit rol; të identifikojë ndryshimet teknike ose funksionale krahasuar me procedurat e viteve 2018 dhe 2022; të shpjegojë vlerën e domosdoshme që niveli Master sjell në raport me një diplomë relevante Bachelor; si dhe të dëshmojë se qëllimi i synuar nuk mund të arrihet përmes një mase më pak kufizuese.

Në mungesë të një arsyetimi të tillë, kërkesa për Master mbetet një kusht formal eliminues, pa lidhje të dëshmuar me aftësinë reale për realizimin e kontratës. Ky kusht kufizon konkurrencën dhe krijon së paku rrezik objektiv të favorizimit të OE-ve që disponojnë profilet akademike të përcaktuara ngushtë. Përvoja profesionale, certifikimet përkatëse dhe projektet e ngjashme përbëjnë mjete më të drejtpërdrejta dhe objektive për verifikimin e aftësive praktike sesa vendosja e një niveli të caktuar akademik si kusht absolut.

Provat historike për të njëjtin sistem. Dosjet e tenderit të viteve 2018 dhe 2022, të hartuara nga i njëjti AK për mirëmbajtjen e sistemit LIMS në AKF, tregojnë se i njëjti objekt është realizuar me kërkesa dukshëm më të gjera dhe më pak kufizuese. Krahasimi i verifikuar është si vijon:

Viti 2018 – Stafi i kërkuar. Janë kërkuar gjithsej tre (3) ekspertë: minimum dy (2) ekspertë për zhvillim të softuerit dhe minimum një (1) ekspert i bazave të të dhënave. Për secilin profil pranohej diplomë universitare në fushën e TI-së OSE certifikatë profesionale relevante, e lëshuar nga kompani certifikuese ndërkombëtare ose të autorizuar prej tyre. Zhvilluesit duhej të kishin mbi 3 vjet përvojë në zhvillim softueri, ndërsa eksperti i bazave të të dhënave mbi 2 vjet përvojë në administrim dhe zhvillim të bazave të të dhënave.

Viti 2022 – Stafi i kërkuar. Janë kërkuar gjithsej tre (3) ekspertë: minimum dy (2) ekspertë për zhvillim të softuerit dhe minimum një (1) ekspert i bazave të të dhënave. Edhe në këtë dosje, për secilin profil pranohej diplomë universitare në fushën e TI-së OSE certifikatë profesionale relevante, e lëshuar nga kompani certifikuese ndërkombëtare ose të autorizuar prej tyre. Zhvilluesit duhej të kishin mbi 3 vjet përvojë në zhvillim softueri, ndërsa eksperti i bazave të të dhënave mbi 3 vjet përvojë në administrim dhe zhvillim të bazave të të dhënave.

Viti 2026 – Stafi i kërkuar. Janë kërkuar gjithsej gjashtë (6) ekspertë: një (1) Menaxher Projekti, dy (2) Zhvillues Softueri, një (1) Analist Sistemi, një (1) Arkitekt Softueri dhe një (1) Ekspert i Bazave të të Dhënave. Për Menaxherin e Projektit, Analistin e Sistemit dhe Arkitektin e Softuerit kërkohet diplomë e caktuar e sistemit të vjetër OSE Master, ndërsa Bachelor-i relevant pranohet vetëm për zhvilluesit dhe ekspertin e bazave të të dhënave. Për Menaxherin e Projektit kërkohen 5 vjet përvojë dhe së paku 2 projekte; për Analistin e Sistemit dhe Arkitektin e Softuerit kërkohen nga 3 vjet përvojë dhe së paku 3 projekte, krahas kërkesave të veçanta për profilet e tjera.

Vlera provuese e krahasimit. Këto nuk janë procedura për sisteme të ndryshme, por kërkesa të hartuara nga i njëjti AK për mirëmbajtjen e të njëjtit sistem LIMS. Në vitet

2018 dhe 2022 AK-ja ka konsideruar të mjaftueshëm një ekip minimal prej tre ekspertësh dhe ka pranuar në mënyrë alternative diplomën universitare në TI ose certifikimin profesional. Në vitin 2026 ekipi minimal është dyfishuar në gjashtë ekspertë, janë shtuar tri role të reja dhe për tri pozita është vendosur Masteri/diploma e caktuar si kusht eliminues. Ky ndryshim i konsiderueshëm nuk është i paligjshëm vetëm pse është më rigoroz, por e ngarkon AK-në me detyrimin që të identifikojë ndryshimin teknik të objektit dhe të arsyetojë konkretisht domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e secilës kërkesë të re. Një arsyetim i tillë mungon.

Dosjet e mëparshme nuk e ndalojnë AK-në t'i përditësojë kriteret kur këtë e kërkon një ndryshim real i nevojës ose i kompleksitetit teknik. Megjithatë, ato përbëjnë provë të drejtpërdrejtë të vlerësimit të mëparshëm të vetë AK-së për burimet e nevojshme për të njëjtin sistem. Përballë kalimit nga 3 në 6 ekspertë, shtimit të tri roleve të reja dhe ngritjes së nivelit akademik në kusht eliminues, AK-ja duhej të paraqiste një analizë të dokumentuar: cilat funksionalitete ose rreziqe të reja e kërkojnë secilin rol, pse detyrat nuk mund të mbulohen nga profilet ekzistuese dhe pse Bachelor-i relevant me përvojë e certifikime nuk është i mjaftueshëm. Deklarimi abstrakt “kompleksiteti i sistemit” nuk e përmbush këtë barrë arsyetimi.

Shkelja. Sipas nenit 51 të LPP-së, ligjshmëria e një kërkesë të përshtatshmërisë profesionale nuk provohet vetëm duke pohuar se ajo lidhet me objektin e kontratës. AK-ja duhet të dëshmojë në mënyrë kumulative se kërkesa është e nevojshme për realizimin e detyrave konkrete, drejtpërdrejt relevante me objektin dhe proporcionale me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës. Ky test nuk është bërë. Nuk është identifikuar asnjë kompetencë që sigurohet vetëm nga niveli Master dhe që nuk mund të dëshmohet me Bachelor relevant, përvojë të kërkuar dhe certifikime profesionale. Kriteri redukton artificialisht rrethin e ekspertëve dhe të OE-ve, krijon një avantazh të pajustificuar për profile shumë specifike akademike dhe cenon konkurrencën efektive. Prandaj janë cenuar nenet 7 dhe 51 të LPP-së dhe nenet 4.3 e 25.17 të Rregullores.

Kërkesa. Të largohet Masteri si kusht eliminues dhe të pranohen diploma Bachelor relevante në Shkenca Kompjuterike, Inxhinieri Kompjuterike/Softuerike, Teknologji Informative, Telekomunikacion ose fusha ekuivalente, së bashku me përvojën dhe certifikimet e kërkuara.

Pretendimi 2 – Objekti dhe vëllimi i LIMS Web/avancimeve do të përcaktohen pas kontraktimit

Fakti. AK-ja ka pranuar se vëllimi i detajuar i finalizimit të LIMS Web do të përcaktohet pas analizës së sistemit. Për avancimet ka deklaruar se do të kërkohen sipas nevojave dhe do të realizohen “brenda kapacitetit të kontraktuar”, pa përcaktuar numrin e moduleve, funksionalitetet e pambaruara, numrin maksimal të kërkesave, orët/ditët e zhvillimit apo kufirin e matshëm të këtij kapaciteti.

Përgjigjja e AK-së në vendim. AK-ja pohon se kërkesat kryesore janë përcaktuar, por nuk i identifikon ato dhe nuk tregon në cilën pjesë të DT-së gjenden sasitë, kufijtë dhe kriteret e pranimit. Përkundrazi, vetë përgjigjja se puna do të përcaktohet pas analizës e

konfirmon paqartësinë.

Shkelja. Analiza fillestare mund të rafinojë mënyrën e implementimit, por nuk mund ta zëvendësojë përcaktimin paraprak të nevojës, objektit dhe kufijve të kontratës. Elementet që ndikojnë drejtpërdrejt në numrin dhe profilin e ekspertëve, kohëzgjatjen, çmimin dhe ekspozimin ndaj penalteteve duhet të jenë të njohura para ofertimit. Përndryshe, çmimi fiks prej 36,000.00 EUR nuk përfaqëson të njëjtin objekt ekonomik për të gjithë tenderuesit: secili detyrohet të ndërtojë supozime të ndryshme, ndërsa OE-ja që e njëj paraprakisht sistemin disponon avantazh informativ. Kjo cenon transparencën, trajtimin e barabartë, konkurrencën dhe krahasueshmërinë reale të ofertave, në kundërshtim me nenet 7, 9, 27 dhe 28 të LPP-së dhe nenet 17.12, 19.1, 19.3 e 19.4 të Rregullores.

Kërkesa. Të publikohen gjendja dhe lista e moduleve, funksionalitetet që duhet të përfundohen, rezultatet, afatet, kriteret e pranimi dhe kufiri maksimal i avancimeve në orë, ditë ose kërkesa.

Pretendimi 3 – Integrimet dhe portali i jashtëm nuk kanë shtrirje të përcaktuar

Fakti. DT përmend integritet me Policinë, Prokurorinë dhe Gjykatat dhe panele për palë të jashtme. AK-ja nuk ka përcaktuar cilat integritet janë detyrues, numrin e tyre, API-të, protokollet, formatet, numrin e institucioneve/përdoruesve, autentikimin, rolet, kërkesat e sigurisë dhe kriteret e pranimi. Në sqarime ka deklaruar se detajet teknike do të përcaktohen gjatë analizës dhe se API-të varen nga institucionet e tjera.

Shkelja. Ankesa nuk kërkon që AK-ja të paracaktojë çdo hollësi të dizajnit teknik. Ajo kërkon minimumin e domosdoshëm të fushëveprimit: cilat integritet janë pjesë e çmimit bazë, sa është kufiri maksimal, cilat janë varësitet nga palët e treta dhe kush mban rrezikun kur API-të, qasjet ose aprovimet nuk vihen në dispozicion. Pa këto të dhëna, tenderuesit nuk çmojnë të njëjtin detyrë dhe kontraktorit mund t'i ngarkohen pas dhënies së kontratës detyrime që nuk kanë qenë objekt i konkurrencës. Janë cenuar nenet 7, 9, 27 dhe 28 të LPP-së dhe nenet 19.1, 19.3 e 19.4 të Rregullores.

Kërkesa. Të përcaktohen integritet dhe panelet e detyrueshme, kufiri maksimal, parakushtet teknike, përgjegjësitë e AKF-së dhe institucioneve të treta, afatet që pezullohen për shkak të palëve të treta dhe kriteret e pranimi.

Pretendimi 4 – SLA-ja, backup-i dhe përgjegjësitë teknike nuk janë plotësisht të matshme

Fakti. DT përmban afate të ndryshme për reagim dhe zgjidhje dhe formulime 4–8 orë. Nuk përcakton plotësisht orarin jashtë punës, rregullat e pezullimit të kohës, retencionin, enkriptimin, RPO/RTO-në, kapacitetin/lokacionin e ruajtjes dhe përgjegjësinë për infrastrukturën e backup-it. Këto janë kërkuar shprehimisht në sqarime. Përgjigjja e AK-së. Vendimi vetëm deklaroi se kërkesat janë të lidhura me funksionimin e vazhdueshëm dhe se kërkesa për formulim më të detajuar nuk provon shkelje. Ky arsyetim nuk i zgjidh kundërthëniet dhe as nuk identifikon parametrat e munguar.

Shkelja. Kur kontraktori mban përgjegjësi për vazhdimësinë e shërbimit, rikthimin e të dhënave dhe pasojat financiare të mosrespektimit, parametrat e performancës duhet të jenë unikë, objektivist të matshëm dhe të njohur para ofertimit. Formulimet alternative ose intervalet e paqarta nuk lejojnë të përcaktohet momenti i fillimit dhe ndalimit të afatit, standardi i përmbushjes apo baza e penalizimit. Kjo krijon diskrecion gjatë administrimit

të kontratës dhe cenon nenet 27 e 28 të LPP-së dhe nenet 19.3 e 19.4 të Rregullores.

Kërkesa. Të publikohet një SLA e harmonizuar dhe të përcaktohen orari, reagimi, zgjidhja, pezullimi i kohës, retencioni, enkriptimi, RPO/RTO, kapaciteti, pajisjet dhe testi i rikthimit.

Pretendimi 5 – Trajnimet, dokumentacioni dhe penalitetet mbeten të papërcaktuara; vendimi nuk e shqyrton tërë pretendimin

Fakti. DT nuk përcakton numrin e pjesëmarrësve, sesioneve dhe orëve të trajnimit, vëllimin e video-tutorialeve, standardin dhe intervalet e dorëzimit të kodit/dokumentacionit. Për penalitetet, DT përmban “5–10%”, “p.sh.” dhe koeficientin 1.5, ndërsa sqarimi i AK-së përmend 0.25% në ditë deri në 10%.

Mungesa e shqyrtimit. Vendimi i datës 21.08.2026 trajton vetëm penalitetin 0.25%/10%, por nuk jep asnjë përgjigje për trajnimet, video-tutorialet, kodin burimor dhe dokumentacionin. Prandaj një pjesë materiale e pretendimit është lënë pa u shqyrtuar. Edhe për penalitetet, deklarimi se norma do të përfshihet në kontratën e ardhshme nuk e zëvendëson nevojën që dokumentet e tenderit të jenë të harmonizuara para dorëzimit të ofertave.

Shkelja. Detyrimet pa sasi dhe penalitetet me norma ose formula kundërtënëse nuk mund të çmohen në mënyrë të njëjtë. Kushtet materiale të kontratës duhet të jenë të qarta në DT dhe nuk mund të plotësohen për herë të parë në kontratën që do të nënshkruhet me OE-në fitues. Për më tepër, mosshqyrtimi i trajnimeve, video-tutorialeve, kodit burimor dhe dokumentacionit përbën mungesë të vendimmarrjes mbi një pjesë materiale të kërkesës për rishqyrtim. Janë cenuar nenet 27 e 28 të LPP-së, neni 108/A për shqyrtim efektiv dhe nenet 17.12, 19.1, 19.3 e 19.4 të Rregullores.

Kërkesa. Të përcaktohet vëllimi i trajnimeve dhe dokumentacionit dhe të publikohet tekst unik i penaliteteve me normën, bazën, formulën, kufirin maksimal, kumulimin, përjashtimet dhe procedurën e kundërshtimit.

Pretendimi 6 – Vendimi i AK-së është i përgjithshëm, përmban pasaktësi faktike dhe nuk vlerëson provat

Pasaktësia. Në pjesën “Pretendimet ankimore”, vendimi thotë se PBC ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim më 29.07.2026, ndërsa kërkesa e bashkëngjitur është e datës 18.08.2026. Kjo nuk është vetëm gabim formal: krijon paqartësi se cilin parashtrësë ka shqyrtuar AK-ja.

Mungesa e arsytimit. Vendimi përdor formulime të përgjithshme si “kompleksiteti i sistemit”, “kërkesat kryesore janë përcaktuar” dhe “duhet të lexohen në tërësi”, pa iu përgjigjur të dhënave konkrete të kërkuara dhe pa cituar pjesët e DT-së që përmbajnë sasi ose kufijtë e pretenduar. Nuk është bërë test i domosdoshmërisë/proporcionalitetit dhe as vlerësim i ndikimit në konkurrencë e krahasueshmëri të ofertave.

Shkelja. E drejta për kërkesë për rishqyrtim do të ishte vetëm formale nëse AK-ja do të mund t’i refuzonte pretendimet me pohime abstrakte, pa analizuar provat, pa iu përgjigjur

secilës çështje materiale dhe pa treguar se ku në DT gjenden të dhënat e pretenduara. Arsyetimi duhet të mundësojë që pala dhe OSHP-ja ta kuptojnë lidhjen ndërmjet fakteve të konstatuara, dispozitave të zbatuara dhe përfundimit të arritur. Pasaktësia për datën e parashtrësës, mosshqyrtimi i një pjese të kërkesës dhe mungesa e testit të proporcionalitetit tregojnë se nuk është kryer shqyrtim i plotë, konkret dhe i verifikueshëm sipas nenit 108/A të LPP-së.

IV. Dëmi dhe interesi juridik

PBC ka interes të drejtpërdrejtë juridik dhe ekonomik për të ofertuar dhe për ta fituar kontratën në një procedurë të ligjshme, të hapur dhe të krahasueshme. Kriteret kufizuese dhe paqartësitë e DT-së rrezikojnë ta pamundësojnë ose ta dëmtojnë pjesëmarrjen e PBC në kushte të barabarta: kriteri i diplomave kufizon angazhimin e ekspertëve relevantë me Bachelor, ndërsa paqartësitë teknike pengojnë kalkulimin objektiv të kostos, resurseve, afatit dhe rrezikut kontraktual. Pa korrigjimin e DT-së, PBC rrezikon eliminimin për një kriter joproporcional ose detyrohet të japë çmim për detyrime që mund të zgjerohen pas kontraktimit. Dëmi material do të përcaktohet dhe dokumentohet sipas nevojës.

V. Praktika relevante dhe kërkesa për vendimmarrje konsistente

Raste me mangësi teknike të njëjta ose materialisht të ngjashme janë trajtuar në ankesat nr. 2025/0780 dhe nr. 2025/1198. Këto raste janë relevante jo për shkak të identitetit të palëve ose emërimit të procedurave, por për shkak të standardit juridik dhe teknik të zbatuar ndaj specifikimeve të papërcaktuara në kontratat e mirëmbajtjes dhe avancimit të sistemeve softuerike.

Në ankesën nr. 2025/0780 u trajtuan, ndër të tjera, mungesa e numrit dhe shtrirjes së moduleve/nënmoduleve, vëllimi i avancimeve, trajnimet, integrimet me sisteme të jashtme dhe lënia e elementeve thelbësore për t'u përcaktuar gjatë zbatimit. Konstatimi teknik ishte se përshkrimet e përgjithshme nuk mjaftojnë: edhe kur zbatohet metodologji agile, para ofertimit duhet të ekzistojë një fushëveprim fillestar i identifikueshëm, kërkesa funksionale dhe jofunksionale, use cases ose user stories, kriteret pranimit/definition of done dhe kufij që mundësojnë planifikimin e resurseve dhe llogaritjen e çmimit.

Në ankesën nr. 2025/1198 u trajtua zbatimi pasues i këtij standardi. Raporti përkatës konstatoi se paqartësitë vazhdonin lidhur me kufirin ndërmjet mirëmbajtjes dhe zhvillimit të funksionaliteteve të reja, vëllimin e avancimeve dhe kufijtë e punës, dhe rekomandoi plotësimin e dokumenteve të tenderit dhe zgjatjen e afatit. Procedura përfundoi pas pajtimit me raportin e ekspertit; për këtë arsye ky rast paraqitet si provë profesionale dhe procedurale e standardit të ndjekur, jo si një vendim i dytë meritator mbi të njëjtën çështje.

Lidhja me ankesën e tanishme. Edhe këtu, finalizimi dhe përshtatja e sistemit, avancimet, integrimet, trajnimet dhe një pjesë e parametrave të performancës mbeten pa sasi ose kufij të matshëm dhe parashihet të konkretizohen pas analizës ose sipas nevojave. Kjo është e njëjta mangësi normative: objekti ekonomik që duhet të çmohet nuk është përcaktuar në masën e nevojshme para konkurrimit.

Siguria juridike dhe trajtimi i barabartë kërkojnë që raste faktikisht dhe juridikisht të krahasueshme të trajtohen në mënyrë konsistente. Nëse në këtë lëndë do të ndiqej qasje

tjetër nga ajo e reflektuar në ankesat nr. 2025/0780 dhe nr. 2025/1198, dallimi duhet të mbështetet në veçori konkrete të DT-së së tanishme dhe të arsyetohet shprehimisht. Në mungesë të një dallimi material, kërkohet zbatimi i të njëjtit standard: plotësimi i DT-së dhe zgjatja e afatit për ofertim.

VI. Kërkesa drejtuar OSHP-së

Duke u bazuar në faktet, provat, dispozitat e cituara dhe praktikën relevante, PBC kërkon që OSHP-ja:

1. ta aprovojë ankesën si të bazuar;
2. ta anulojë Vendimin e AK-së të datës 21.08.2026;
3. ta obligojë AK-në ta ndryshojë DT-në duke pranuar Bachelor-in relevant për tri pozitat e kontestuara, krahas përvojës dhe certifikimeve të kërkuara;
4. ta obligojë AK-në t'i plotësojë dhe harmonizojë specifikimet me vëllimin, sasinë, afatet, rezultatet, përgjegjësitë, SLA-në, trajnimet, dokumentacionin, integritet, backup-in dhe kriteret e pranimit;
5. ta obligojë AK-në të publikojë tekst unik dhe përfundimtar të penalteteve;
6. ta obligojë AK-në ta zgjasë afatin e dorëzimit të tenderëve në pajtim me afatin ligjor pas çdo ndryshimi material të DT-së;
7. në alternativë, nëse vlerëson se mangësitë nuk mund të korrigjohen pa ndryshuar thelbësisht objektin dhe kushtet e konkurrimit, ta anulojë njoftimin për kontratë dhe ta obligojë AK-në ta rishpallë procedurën me dokumente të plota, të qarta dhe proporcionale;
8. ta mbajë aktivitetin të pezulluar deri në vendosjen përfundimtare lidhur me këtë ankesë.

VII. Provat

Dosja e Tenderit e korrigjuar, datë 31.07.2026 – nr. 214-26-6338-2-2-1;

1. Kërkesa e PBC për informacione shtesë, datë 13.08.2026;
2. Informacione/sqarime shtesë të DT-së, datë 17.08.2026;
3. Kërkesa për rishqyrtim e PBC, datë 18.08.2026;
4. Vendimi i AK-së në kërkesën për rishqyrtim, datë 21.08.2026;
5. Dosja e Tenderit 2018 për kontratën kornizë “Shërbime – Mirëmbajtja e sistemit LIMS”, veçanërisht pikat 9.1 dhe 9.2 të FDT-së, si provë e numrit të stafit, profileve, përvojës dhe dëshmimeve të pranuar;
6. Dosja e Tenderit 2022 “Mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit të informatave në laborator (LIMS) në AKF”, nr. 214-22-1548-2-2-1, veçanërisht pikat 9.1 dhe 9.2 të FDT-së, si provë e numrit të stafit, profileve, përvojës dhe dëshmimeve të pranuar;
7. Vendimi i Panelit Shqyrtues të OSHP-së nr. 2025/0780, datë 17.10.2025;
8. Raporti i ekspertit shqyrtues/teknik në lëndën OSHP nr. 2025/0780;
9. Vendimi i OSHP-së nr. 2025/1198, datë 26.01.2026, dhe raporti përkatës i ekspertit shqyrtues/teknik;
10. Dëshmia e pagesës së tarifës së ankesës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale dhe jomateriale do të përcaktohen pas një ekspertize financiare.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*